



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 303/1 Prot.

Tiranë, më 06 . 03 . 2024

**V E N D I M**

**Nr. 56., Datë 06 . 03 . 2024**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja b), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup> mori në shqyrtim ankesën me nr. 24 Regj., datë 15.02.2024, të znj. Zh. L kundër gazetarit S. B, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjeve filozofike”, “gjendjes civile” dhe “gjinisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Referuar formularit të ankesës së depozituar pranë KMD-së, tek shpjegimi i fakteve për diskriminimin e pretenduar, subjekti ankues, Zh. L, ka parashtruar problematikën e lindur gjatë pjesëmarrjes së saj në emisionin “Now me E. M”, të datës 13.02.2024, në televizionin Euronews, ku ajo ka qenë e ftuar në një panel me figura të tjera publike, ndër të cilët edhe gazetari S. B.

Në ankesën e paraqitur, subjekti ankues pretendon se është sulmuar nga gazetari S. B, me qëllim për të fyer, denigruar dhe përdhosur angazhimin e kontributin e dhënë për kauzën feministe.

Tematika e diskutimit në këtë panel ishte rreth rastit të së ndjerës S. A, e cila dyshohet t’i ketë dhënë fund jetës për shkak të shantazhimit të një personi në rrjetet sociale, për publikimin e

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

fotove të saj personale. Ankuesja citon se, debati në emisionin në fjalë mori krejtësisht një rrjedhë tjetër, pasi gazetari S. B iu drejtua asaj duke përdorur epitete si “zemra ime”, me qëllimin për të tensionuar gjendjen mes të ftuarve.

Në shpjegim të shkakut për të cilin ankuesja pretendon se diskriminohet, ndër të tjera citon se: *“Gazetari B e cilësoi gazetaren si individ që nuk ka tagër për të folur për tematika gjinore “me argumentin” se nuk është nënë. Në sajë të këtij banaliteti, gjatë emisionit por dhe jashtë kamerave, S. B dëshmoi se patriarkati është një fenomen shumë shqetësues për shoqërinë tonë. Gratë në emisione nuk trajtohen si të barabarta, por si shtojca. Nxitja dhe ushqyerja e opinionit me këtë lloj narrative, përpos se sulmon fjalën e lirë, thyhen etikën në media, cenon dinjitetin e grave dhe forcon drejtëpërdrejtë retorikën e patriarkatit.*

*Gazetarja Zh. L ka kërkuar që gazetari i kronikës S. B të largohet nga emisioni, në mënyrë që të mos ndihej e detyruar të braktiste emisionin, duke lënë në mes edhe mesazhin që kërkonte të përcillte.”*

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri, marrjen e masave të duhura ligjore.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me*

*Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi si të një autoriteti publik, ashtu edhe çdo personi fizik apo juridik që merr pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë.

Për sa më lart, *së pari*, lidhur me pretendimin për diskriminim përmes gjuhës së përdorur nga gazetari S. B, subjekti ankues, znj. Zh. L, i referohet bisedës së zhvilluar mes tyre, në kuadër të pjesëmarrjes në emisionin “Now me E. M”, të datës 13.02.2024, në televizionin Euronews, ku ata ishin pjesë e panelit të të ftuarve.

Lidhur me verifikimin e kontentit të bisedës së zhvilluar mes ankueses dhe gazetarit S. B, Komisioneri iu referua transmetimit të emisionit në fjalë, të cilin e aksesoi në linkun: <https://www.youtube.com/watch?vOosn1KpwCU>

Titulli i emisionit ishte: “Kush e vrau Sibelën?” dhe pjesëmarrës në panel ishin 5 (pesë) të ftuar, ndër të cilët edhe ankuesja dhe gazetari S. B.

Gjatë shpjegimeve që njëri nga të ftuarit në panel, po bënte lidhur me ngjarjen e dyshuar si vetëvrasje të së ndjerës S. A, prezantimin e historisë së saj familjare dhe intervistimit që kishte bërë me nënën dhe vëllain e viktimës, u përfshinë në një debat e diskutim me tone të ngritura ankuesja Zh. L dhe gazetari S. B.

Duke diskutuar për ngjarjen, gjatë bisedës, gazetari S. B, ka interpretuar veprimet e të afërmëve të së ndjerës, në kontekst të mentalitetit të shoqërisë shqiptare. Ndër të tjera, fragmentarizojmë bisedën e zhvilluar mes ankueses dhe gazetarit S. B, lidhur me pretendimin e ankueses për përdorim të dhunës verbale dhe gjuhës fyese, denigruese e diskriminuese kundrejt saj, për shkaqet e pretenduara të: bindjeve filozofike, gjendjes civile dhe gjinisë.

Lidhur me diskutimet e të ftuarve rreth ngjarjes fatkeqe, shkaqeve dhe rrethanave të rastit në fjalë, ndër të tjera, citojmë pjesë të shkëputura nga debati i krijuar mes ankueses dhe z. S. B, si vijon:

*“S. B - Ky është mentaliteti moj zemra ime....*

*Zh. L – Ky është mentaliteti që nuk i trajton vajzat si të barabarta, ky mentaliteti që promovon...unë nuk quhem zemra ime...unë quhem Zh. L, ky mentaliteti që një grua nuk e quan të barabartë në këtë tavolinë ... ky është mentaliteti që po i vret vajzat shqiptare... kur thirrje të tilla bëhen nga figura publike, vajzat nuk shkojnë të denoncojnë në polici..*

*S. B – Dakord, u shpreha gabim, më fal... ”*

Në referencë të sa më sipër, lidhur me analizimin e kontentit të debatit të zhvilluar mes ankueses dhe gazetarit, z. B, Komisioneri vlerëson se gjuha e përdorur nga gazetari, lidhur me mënyrën se si i drejtohet znj. L me togfjalëshin “zemra ime”, apo dhe duke iu drejtuar se ajo nuk mund të fliste për ngjarje të tilla pasi nuk ishte nënë vetë, është gjuhë e papërshtatshme dhe ka elementë fyese.

Gjuha e përdorur përmban elementë të një “sulmi a debati personal”, absolutisht të dënueshëm në rrafshin e komunikimit njerëzor, gazetaresk dhe televiziv, por nuk përmban elementët që të mund ta klasifikonin atë si sjellje diskriminuese.

Komisioneri vëren se, diskursi konfliktual i debateve televizive shqiptare në tërësinë e vet, lë shumë për të dëshiruar, si nga forma, ashtu edhe përmbajtja dhe vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen që figurat publike, funksionarët publikë apo klasa politike, të tregohen të kujdesshëm në gjuhën e përdorur prej tyre.

Gjatë aktivitetit të tij, Komisioneri ka dënuar fuqimisht përdorimin e gjuhës fyese dhe intolerancës ndaj një komuniteti apo individi të caktuar, nga ana e individëve që bëjnë pjesë në jetën publike.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta<sup>3</sup> si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë mbron njëkohësisht lirinë e shprehjes në nenin 22 të saj ku parashikohet se: *“Liria e shprehjes është e garantuar”*, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon se të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në të mund të kufizohen. Kështu, në nenin 17 të saj sanksionohet se: *“Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetem me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. 2. Këto kufizime nuk mund të çënojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

Pra, shohim se, Kushtetuta e lidh kufizimin e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në të, me detyrimin për të mos tejkaluar kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare<sup>4</sup>, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njihet dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta. Neni 14 i Konventës garanton barazinë “në gëzimin e të drejtave dhe lirive” të përcaktuara në të. Protokollin 12 i saj ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe në fushëveprimin e tij sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.<sup>5</sup>

<sup>3</sup> Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, sanksionon në nenin 18 se : *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatesia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”*.

<sup>4</sup> Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

<sup>5</sup> Protokollin 12-të i KEDNJ-së.

Ushtrimi i lirisë së shprehjes përmban në vetvete detyrime dhe përgjegjësi. Sipas paragrafit të dytë të nenit 10 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ushtrimi i kësaj lirie nuk mund të çenojë dinjitetin dhe të drejtat e të tjerëve. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka theksuar në gjykime të ndryshme se: *“Toleranca dhe respekti për dinjitetin e barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. Duke qenë kështu, si çështje parimore mund të konsiderohet e nevojshme në disa shoqëri demokratike që të sanksionojnë ose madje të parandalojnë të gjitha format e shprehjes që përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen e bazuar në jo tolerancë ..., me kusht që çdo “formalitet”, “kusht”, “kufizimet ose gjobat” janë proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur. (Erbakan v. Turkey, Aktgjykimi i 6 korrikut 2006, § 56)”. Duke qenë kështu lind nevoja e parandalimit të të gjitha formave të shprehjes të cilat përhapin, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen bazuar në mungesën e tolerancës.*

Gjuha e urrejtjes për qëllim të Rekomandimit ECRI(2016)15 përfshin përdorimin e një ose të disa formave më të veçanta të shprehjes, si psh, mbrojtjes, promovimit apo nxitjes së denigrimit, urrejtje apo shpifje të një personi ose grupi personash, si dhe çdo ngacmim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim apo kërcënim i një personi ose disa personave dhe çdo justifikim të të gjithë formave të shprehjes - që është i bazuar në një listë jo shteruese të karakteristikave personale ose statusin që përfshin "raca", ngjyra, gjuha, feja apo besimi, kombësia apo origjina kombëtare ose etnike, si prejardhja, mosha, aftësia e kufizuar, seksi, gjinia, identiteti gjinor dhe orientimi seksual<sup>6</sup>.

Sipas GJEDNJ, sulmi kundër reputacionit të personit duhet të arrijë një nivel të rëndë në mënyrë që të shkaktojë paragjykim të gëzimit të së drejtës se respektimit të së drejtës nga individi.

Ligji për Mediat Audiovizive garanton se aktiviteti i transmetimit i shoqërive të jetë në përputhje me të drejtën për informacion, e bindjeve politike dhe fetare, personalitetin, dhe dinjitetin si dhe me të tjera të drejta dhe liri themelore të njeriut. Transmetimi mediatik duhet të udhëhiqet nga parimet e “moslejimi i transmetimeve që nxisin intolerancën ndërmjet shtetasve”. Ligji parashikon se shërbimi i mediave audio dhe/ose audiovizive nuk duhet të përmbajë asnjë nxitje ndaj urrejtjes mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare (Neni 32). Operatorët e shërbimeve audiovizive nuk lejohen të transmetojnë programe me përmbajtje që të nxisin urrejtjen mbi baza racore, gjinie, fetare, etnike, kombëtare dhe çdo forme tjetër diskriminimi (Neni 76).

Kodi i Transmetimit për Median Audiovizive përfshin dhe përcakton parimet, rregullat, kushtet dhe praktikat për transmetimin audioviziv në Republikën e Shqipërisë. Kodi i Transmetimit është hartuar si instrument zbatues i ligjit Për Mediat Audiovizive në përputhje me Direktivën e BE-së 2010/13 (“Direktiva e Shërbimeve të Medias Audiovizive”) dhe aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut si KEDNJ. Kodi përshkruan disa parime

<sup>6</sup> Përkthim i Komisionerit. ECRI General Policy Recommendation No.15 “On combating hate speech” CRI (2016)15. Adopted on 8 December 2015. B.9 Definition (s).

për shërbimet audiovizive midis të cilave janë dekurajimi i urrejtjes, intolerancës dhe diskriminimit për shkaqe të tilla si raca, gjinia, orientimi seksual, besimit politik (1.5); respektimi i së drejtës për barazi; dhe mosdiskriminim nga transmetimet audiovizive të të gjitha llojeve (1.12).

Në lidhje me vetë-rregullimin e mediave është miratuar Kodi i Etikës së Gazetarit<sup>7</sup>, i cili është hartuar nga ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë (përfshirë gazetarët) në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës “Përforcimi i Ekspertizës Gjyqësore për Lirinë e Shprehjes dhe Mediave në Evropën Juglindore” (JUFREX).

Parimet e këtij Kodi janë në përputhje me vlerat etike universale të gazetarisë, të njohura dhe të pranura gjerësisht nga mediat dhe organizatat e gazetarëve në vendet demokratike. Ato përbëjnë gurin e themelit të pluralizmit demokratik dhe po ashtu respektojnë frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në kontekst të sa më sipër, Kodi i Etikës është një instrument vetë-rregullues i cili synon të drejtë, forcojë dhe përmirësojë cilësinë e gazetarisë dhe ndjenjën e përgjegjësisë së gazetarëve në Shqipëri. Parimet e këtij Kodi janë në përputhje me vlerat etike universale të gazetarisë dhe respektojnë frymën e Kushtetutës, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kodi etik përfaqëson një përmbledhje normash dhe rregullash etike lidhur me çështje më të rëndësishme etike që hasen gjatë ushtrimit të gazetarisë.

Media është mjeti nëpërmjet të cilave bëhet e mundur shpërndarja e informacionit drejt një pluraliteti marrësish ose publiku, pa dallim. Një nga çështjet më me debat në fushën e gazetarisë është etika gazetareske, e cila në shumë raste lë për të dëshiruar. Ekranin përveç misionit informativ në vetvete ka si qëllim përcjelljen e kulturës në kuptimin e thellë dhe të plotë të saj, duke filluar nga mesazhi dhe opinionet e profesionistëve deri tek sjellja dhe etika qytetare.

Në shoqëritë multikulturore, të cilat karakterizohen nga shumëllojshmëri traditash, besimesh fetare dhe mënyrash jetese, ndonjëherë është e nevojshme që e drejta për lirinë e shprehjes të ekuilibrohet me të drejtën e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, ose të drejtën për të qenë i mbrojtur nga diskriminimi. Arritja e kësaj mbrojtjeje, bëhet përmes balancës mes tyre, pasi këto të drejta përbëjnë shtyllat themelore të një “shoqërie demokratike”.

Shqipëria ka zhvilluar një kuadër ligjor të përshtatshëm për të trajtuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut si dhe për ndalimin e diskriminimit. Si anëtare e Këshillit të Evropës dhe shtet kandidat në Bashkimin Evropian, Shqipëria është pjesë e akteve ndërkombëtare përkatëse. Shqipëria ka përmirësuar shpesh legjisllacionin me synim harmonizimin me standardet ndërkombëtare dhe të Bashkimit Evropian. Legjisllacioni aktual vlerësohet se është në përputhje me standardet ndërkombëtare mbi gjuhën e urrejtjes.

---

<sup>7</sup> Kodi i Etikës së Gazetarit (2018) i disponueshëm në <https://kshm.al/en/about-us/code-of-ethics/> (30.4.2020)

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: +355 4 2431078, E-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al), Web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

LMD, në nenin 3, pika 8 e tij, ka përcaktuar se, “*Gjuha e urrejtjes*” është çdo formë e shprehjes në publik, me çdo mjet, e promovimit, nxitjes së denigrimit, urrejtjes ose shpifjes, çdo shqetësim, fyerje, stereotip negativ, stigmatizim ose kërcënim ndaj një personi ose grupi personash, si dhe çdo justifikim i të gjitha formave të shprehjes e bazuar në një listë joshteruese të shkaqeve, sipas nenit 1 të këtij ligji.

Po ashtu, në pikën 13, të po këtij neni, ka përkufizuar “*Shqetësimin*”<sup>8</sup> si formë e diskriminimit që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e mbrojtura, i cili ka për qëllim apo efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe në rastin e një trajtimi më pak të favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë.

Nga analizimi i kontetit të emisionit në fjalë dhe pretendimeve të ankueses në tërësinë e tyre, Komisioneri vlerëson shprehjen dhe gjuhën e përdorur nga gazetari S. B, si gjuhë të papërshtatshme, jo etike dhe jo të duhur karshi ankueses, si pjesëmarrëse në panel, në shkelje të normave etike dhe qytetare por edhe të etikës së gazetarit, por gjykon se, shprehja “zemra ime” dhe gjuha e përdorur gjatë debatit nga gazetari S. B, nuk krijon *prima facie* përshtypjen e përdorimit të gjuhës urrejtjes.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri gjykon se, realizimi dhe transmetimi i emisioneve të tilla televizive, si emisioni në fjalë, dhe jo vetëm, është në funksion të qëllimeve dhe detyrës së vetë medias, me synim sensibilizimin e opinionit publik lidhur me parandalimin e ngjarjeve të tilla në të ardhmen, si dhe me emancipimin e edukimin e shoqërisë me mënyrën se si duhen trajtuar e adresuar problematika të tilla, sa herë që individë të caktuar (cilëdo qofshin ata) ndihen të kërcënuar, shantazhuar e bullizuar në rrjetet sociale.

Po ashtu mbetet detyrë e medias e televizionit specifiku në rastin në fjalë, që të përmbushë e realizojë këtë të drejtë të informimit të publikut, e po atë, dhe të transmetojë edhe opinionet dhe vlerësimet e individëve të ndryshëm lidhur me këndvështrimet e tyre për këtë çështje të shtruar për diskutim, në respektim të fjalës dhe personalitetit të secilit prej tyre.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili parashikon se: “*Ankesa nuk pranohet nëse: është haptazi e pabazuar.....*”, ankesa nr. 24 Regj., datë 15.02.2024, e znj. Zh. L kundër gazetarit S. B, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjeve filozofike”, “gjendjes civile” dhe “gjinisë”, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj<sup>9</sup>.

---

<sup>8</sup> “*Shqetësim*” është ajo formë diskriminimi që ndodh në rastin e një sjelljeje të padëshiruar, kur lidhet me cilëndo nga shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji, që ka për qëllim ose efekt cenimin e dinjitetit të personit dhe krijimin e një mjedisi frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues a ofendues për atë person, si dhe trajtimi më pak i favorshëm, i kryer si rezultat i kundërshtimit ose i mosnënshtrimit nga ana e personit të cënuar ndaj një sjelljeje të tillë.

<sup>9</sup> Për analogji citojmë vendimet e KMD-së me: nr. 46/2020, nr. 145/2022, nr. 250/2023.

Së dyti, Komisioneri vëren se, në rastet kur ka vlerësuar dhe konstatuar përdorimin e gjuhës së urrejtjes, në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë ka konkluduar se është prekur apo afektuar një grup i gjerë personash, të cilët i bashkon një veçori apo shkak i përbashkët dhe i identifikueshëm si i tillë në LMD. Ndërsa, në kontekst të përdorimit të gjuhës jo etike apo me nota fyese dhe kundrejt një individi të caktuar dhe në rrafshin personal, ka konkluduar se kjo bën pjesë në juridiksionin civil ose penal, dhe çdo kontestim lidhur me përdorimin e saj, mund t'i drejtohet organeve kompetente.

Për rrjedhojë, lidhur me pretendimin e znj. L për përdorim të dhunës verbale dhe fyerjeve me qëllim denigrimit e përdhosjen e figurës së saj nga ana e gazetarit S. B, Komisioneri vëren se, të gjitha këto pretendime mund t'i drejtohen Autoritetit të Mediave Audiovizive/AMA, si autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive dhe shërbimeve të tjera mbështetëse në territorin e Republikës së Shqipërisë<sup>10</sup>, apo mund të bëhen pjesë e hetimit e shqyrtimit të organeve kompetente të drejtësisë, si: prokurori e gjykatë.

Kodi Penal, në nenin 1<sup>11</sup>, të tij, parashikon se: *“Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundërvajtje penale. Dallimi i tyre bëhet në çdo rast në dispozitat e pjesës së posaçme të këtij Kodi.”*

Në nenin 119, “Fyerja”, përcaktohet se: *“Fyerja e qëllimshme e personit përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në një milion lekë.*

*Po kjo vepër, kur kryhet botërisht, në dëm të disa personave ose më shumë se një herë, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë nga pesëdhjetë mijë gjer në tre milionë lekë.”*

Në këtë kontekst, bazuar në sa më lart, Komisioneri nuk ka tagër e kompetencë ligjore për hetimin, shqyrtimin e vlerësimin e pretendimeve të tilla që apriori mund të përbëjnë elementë të kundërvajtjeve a veprave penale, që hetohen e janë objekt i punës së organeve respektive të drejtësisë. Për rrjedhojë dhe shqyrtimi i tyre është jashtë kompetencave të KMD-së, dhe për pasojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Në nenin 33, pika 4/b, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, përcaktohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) .....është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji.”* Mungesa e kompetencës së Komisionerit për shqyrtimin e këtyre pretendimeve të paraqitura nga ankuesja, e bën ankesën lidhur me këto kërkitime, të papajtueshme me dispozitat e këtij ligji, dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

## **PËR KËTO ARSYE:**

---

<sup>10</sup> Bazuar në ligjin nr. 97/2013 *“Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë”*.

<sup>11</sup> *“Ligji penal dhe ndarja e veprave penale”*



Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/b/ç, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Mospranimin e ankesës me nr. 24 Regj., datë 15.02.2024, të subjektit ankues Zh. L, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**